

## KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Lidhur në Tiranë, sot, më 05.05 2023, ndërmjet palëve të mëposhtme:

### SHITËSI:

**Z. Marin Gjonaj**, i biri i Besnikut dhe Brixhidës, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 30.08.1985 dhe banues në Tiranë, në adresën: Dëshmorët e 4 Shkurtit; Nd.56; H.4; Ap.5; Njësia Administrative Nr.5; Njësia Bashkiake Nr.5; 1019; identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I50830192B, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar (*më tej referuar si "Shitësi"*).

### BLERËSI:

**Z. Ermand Hysi**, i biri i Bilait dhe Bukurijes, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 21.04.1964 dhe banues në Tiranë, në adresën: Rr. "Qemal Stafa"; Nd.19; H.1; Ap.5; Njësia Administrative Nr.2; 1003; identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal G40421113D, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar (*më tej referuar si "Blerësi"*).

### DHËNËS PËLQIMI:

**Znj. Fationa Gjonaj**, e bija e Albert-it dhe Shane-s, lindur në Tiranë, më 16.11.1986 dhe banuese në Tiranë, në adresën: Dëshmorët e 4 Shkurtit; Nd.56; H.4; Ap.5; Njësia Administrative Nr.5; Njësia Bashkiake Nr.5; 1019; identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I66116031A, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

(*së bashku referuar si "Palët"*)

### BAZA LIGJORE:

Nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

### DEKLARIME PARAPRAKE

1. Shitësi është ortak i vetëm në shoqerinë "CRYPTO WORLD" SHPK, regjistruar pranë QKB me NUIS M11908037V, me seli në Tiranë, në adresën: Njësia Administrative Nr. 2, Rruga e Elbasanit, Objekti Park Gate, katë i I-re, me kapital bazë prej 100 lekë (*më tej referuar si "Shoqëria"*), ku është zotëruesh i 1 (një) kuote, me vlerë nominale 100 (Njëqind ) lekë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapitalin bazë të shoqërisë (*më tej referuar si "Kuota"*).
2. Shitësi kërkon të shesë Kuotën e zotëruar prej tij në Shoqëri dhe Blerësi është i interesuar ta blejë atë.
3. Bashkëshortja e Shitësit, dhënësja e pëlqimit Znj. Fationa Gjonaj, jep pëlqimin e saj të plotë e të parevokueshëm për shitjen e Kuotës.

Për këto arsyen, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacenuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë për Shitjen e Kuotës që Shitësi zotëron në shoqerinë "CRYPTO WORLD" SHPK (*më tej referuar si "Kontrata"*), me kushte si më poshtë vijojnë:



### NENI 1

#### Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e 1 (një) kuote me vlerë nominale prej ALL 100 (njëqind lekë) e cila përfaqëson 100% të kapitalit bazë të shoqërisë, të zotëruar nga Shitësi në favor të Blerësit.

### NENI 2

#### Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Marrë në konsideratë marrëdhënien e posaçme mes Shitësit dhe Blerësit, Kuota do të shitet në vlerë nominale dhe çmimi i shitjes së saj do të jetë ALL 100 (njëqind lekë) neto.
- 2.2 Çmimi është paguar nga Blerësi në favor të Shitësit *cash* në momentin e hartimit të kësaj kontrate.
- 2.3 Të gjitha pagesat lidhur me ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të mbarten nga Shitësi, me përjashtim të komisioneve dhe tarifave për transfertën bankare të çmimit të kuotës dhe taksave/tatimeve që lidhen me shitblerjen e kuotës që mbarten nga Blerësi.

### NENI 3

#### Kalimi i pronësisë mbi kuotën

- 3.1 Me nënshkrimin e kontratës, Blerësi bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 3.2 Regjistrimi i Kontratës pranë institucioneve përgjegjëse (si për shembull: Qendra Kombëtare e Biznesit) do të ketë funksion deklarativ ndaj të tretëve dhe Blerësi fiton pronësinë mbi kuotën në momentin e përcaktuar në nenin 3.1 më sipër, pavarësisht momentit se kur kjo Kontratë regjistrohet dhe publikohet pranë institucioneve përgjegjëse.

### NENI 4

#### Pasojet e shitjes së kuotës

- 4.1 Palët bien dakord se si pasojë e shitjes së kuotës, Blerësi do të bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 4.2 Çdo e drejtë apo detyrim i Shitësit në lidhje me shoqerinë, i cili daton përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate do të mbetet ekskluzivisht i tiji.
- 4.3 Me lidhjen e Kontratës, Shoqëria do të zotërohet nga ortaku i vetëm i mëposhtëm:
- 4.3.1 Ortaku Ermand Hysi, bëhet zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale 100 lekë e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% në kapital bazë të Shoqërisë;

### NENI 5

#### Garancitë e Palëve

- 5.1. Shitësi garanton Blerësin se:

- 5.1.1. Zoteron 1 (një) kuotë në Shoqëri, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të saj bazë, e cila është në vlerën 100 (njëqind) lekë. Kuota në tërësinë e saj nuk është subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjeter i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve; Kuota e Shoqërisë gjithashtu nuk është subjekt i barre reale apo juridike.
- 5.1.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjeter, qoftë ky fizik apo juridik, me përjashtim të dhënësve të pëlqimit në këtë kontratë;
- 5.1.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate;
- 5.1.4. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Konratën në vetvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes shoqërisë dhe të tretëve apo Shitësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;
- 5.1.5. Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Shoqërisë.

## 5.2. Blerësi garanton Shitësin se:

- 5.2.1. Blerja e 1 kuote e cila përfaqëson 100% të kapitalit të bazë të Shoqërisë, e zotëruar nga Shitësi është në përputhje me vullnetin e tij;
- 5.2.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjeter, qoftë ky fizik apo juridik;
- 5.2.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate;
- 5.2.4. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Konratën në vetvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;
- 5.2.5. Vlera monetare e përdorur për blerjen e kuotës sipas kontrate është krijuar si pasojë e veprimitarisë së ligjshme.
- 5.2.6. Blerësi nuk është subjekt i ndonjë procesi penal lidhur me veprimitarinë e tij;

## NENI 6 Konfidencialiteti

- 6.1. Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negocim parakontraktor do të trajtohen në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëni tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.
- 6.2. Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:
  - 6.2.1. Pala tjeter ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;

- 6.2.2. Transmetimi bëhet në kuadër të përbushjes së një detyrimi;
- 6.2.3. Transmetimi i bëhet një këshilltari të shoqërisë, i cili është subjekt i detyrimit të ruajtjes së konfidentialitetit (p.sh. Avokatit, ekspertit kontabël);
- 6.2.4. Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetencë të Palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- 6.2.5. Nevojitet për ndjekjen e interesave legjitimë të palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- 6.2.6. Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjeter dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
- 6.2.7. Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njoitura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

#### NENI 7

##### **Komunikimi ndërmjet palëve**

- 7.1. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-mail-it, në adresat dhe e-mailet e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.
- 7.2. Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palen tjeter brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.
- 7.3. Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përashtim të rasteve të parashikuara nga neni 6.2 i kësaj Kontrate.

#### NENI 8

##### **Interpretimi i kontratës**

- 8.1. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 8.2. Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e më specifikisht, nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).

#### NENI 9

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 9.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpilen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 9.2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## NENI 10

### Forca madhore

- 10.1. Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftë, mosbindjen civile, stuhitë, përblytjet ose grevat.
- 10.2. Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

## NENI 11


### Të tjera

- 11.1. Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:
- 11.1.1. Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;
  - 11.1.2. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë;
  - 11.1.3. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, datë 05.05.2023.
- 11.2. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim.
- 11.3. Kjo kontratë përbëhet nga 6 (gjashtë) faqe dhe është hartuar në 6 (gjashtë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese, një për tu arkivuar nga Shoqëria dhe një për tu regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 11.4. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.


#### SHITËSI:

  
Marin GJONAJ

#### BLERËSI:

  
Ermand HYSJ

#### DHËNËS PËLOIMI:

  
Fationa GJONAJ  
